

MEMORANDUM MIRËKÛPTIMI

NDËRMJET

MINISTRISË SË PUNËVE TË JASHTME TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
PËRFAQËSUAR PËRMES AKADEMISË DIPLOMATIKE

DHE

MINISTRISË SË PUNËVE TË JASHTME DHE TË KULTIT TË REPUBLIKËS SË  
KOSTARIKËS  
PËRFAQËSUAR PËRMES INSTITUTIT TË SHËRBIMIT TË JASHTËM “MANUEL  
MARÍA DE PERALTA”

Akademia Diplomatike e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe e Kultit e Republikës së Kostarikës, përmes Institutit të Shërbimit të Jashtëm, “Manuel María de Peralta” (tash e tutje referuar si “Palët”),

Duke NJOHUR natyrën e bashkëpunimit që ekziston ndërmjet Kosovës dhe Kostarikës;

TË GATSHME që të promovojnë një bashkëpunim më të ngushtë në shkollat e diplomatëve;

Janë pajtuar, si në vijim:

## **Neni 1 Qëllimi**

Qëllimi i këtij Memorandumi të Mirëkuptimit është krijimi i kushteve për mbajtjen e kontakteve periodike dhe promovimi i bashkëpunimit ndërmjet Palëve.

## **Neni 2 Bashkëpunimi**

Palët do të bashkëpunojnë në këmbimin e informatës dhe të përvojave në lidhje me programet e tyre përkatëse të studimit dhe të hulumtimit, seminareve dhe aktiviteteve të tjera akademike dhe të edukimit.

Palët do të mund të eksplorojnë mundësitë e formave të tjera të bashkëpunimit të ndërlidhura me qëllimet e këtij Memorandumi.

## **Neni 3 Çështjet me interes të përbashkët**

Palët do të promovojnë kontaktin dhe këmbimin e bursistëve, ekspertëve dhe hulumtuesve. Palët do të nxisin studimin dhe investigimin, si dhe këmbimin e informatës rreth publikimeve kombëtare dhe ndërkombëtare, posaçërisht në fushat me interes të përbashkët.

## **Neni 4 Këmbimi i informatës**

Palët do të këmbejnë informatën dhe opinionet e ndërlidhura me tendencat dhe avancimet në trajnim, investigim ndërkombëtar në diplomaci, politikë të jashtme, marrëdhënie ndërkombëtare, të drejtën ndërkombëtare, marrëdhëniet ekonomike me jashtë, shkencat politike dhe në fushat e tjera relevante.

## **Neni 5 Projektet e ndërmarra bashkërisht**

Palët do të vendosin, përmes kanaleve diplomatike, detajet dhe logjistikën e secilit projekt që e ndërmarrin bashkërisht. Për këtë qëllim, nëse është e nevojshme, do të përfshihen protokollat që i përshkruajnë kushtet e këmbimeve të propozuara.

## **Neni 6 Kushtet financiare**

Format, kohëzgjatjet dhe kushtet financiare të këmbimit dhe të trajnimit të përfaqësuesve të Palëve, do të rregullohen ndërmjet tyre.

**Neni 7**  
**Zgjidhja e kundërthënieve**

Mosmarrëveshjet dhe diskutimet të ndërlidhura me interpretimin dhe aplikimin e këtij Memorandumi do të zgjidhen ndërmjet Palëve përmes konsultimeve.

Dispozitat e këtij Memorandumi do të mund të modifikohen me pëlqim reciprok të Palëve.

**Neni 8**  
**Hyrja në fuqi**


Ky Memorandum do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit të tij dhe do të vazhdojë si i tillë për një periudhë tre vjeçare. Do të mund të vazhdohet automatikisht për periudhë të njëjtë kohore, vetëm nëse njëra nga Palët vendosë ta përfundojë atë përmes njoftimit me shkrim prej nëntëdhjetë (90) ditësh para përfundimit të Memorandumit. Përfundimi i këtij Memorandumi nuk do të ndikojë realizimin e projekteve aktuale, të cilat do të vazhdojnë deri në realizimin e plotë të tyre, vetëm nëse Palët merren vesh ndryshe.

NË DËSHMI TË KËSAJ, të nënshkruarit e mëposhtëm, të autorizuar për efektet, e kanë nënshkruar këtë Memorandum,

Në Qytetin e Panamasë, më 29 muaji tetor 2015, në dy kopje origjinale në shqip dhe në spanjisht, duke qenë të dyja tekstet autentike.

  
Nga ana e Akademisë Diplomatike  
Republika e Kosovës

Zotëri Skënder Durmishi, Drejtor

  
Nga ana e Institutit të Shërbimit të Jashtëm  
“Manuel María de Peralta”

Zonja Ingrid Picado Monge, E Ngarkuar me Punë  
e Përkohshme e Ambasadës së Kostarikës në  
Panama